



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE
KONTROLLIT TË SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

PRILL, 2026

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin prill 2026 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara, dhe në disa raste edhe ato të dyshuara dhe të mundshme sipas përkufizimit të rastit.

1. Sëmundjet diarreike

Për muajin prill incidenca e sëmundjeve diarreike është 263.6 raste për 100,000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike me incidencë 262.7 / 100000 banorë. Gjatë periudhës 02–04.04.2026, NJVKSH Gramsh raportoi 4 raste të konfirmuara me salmonelozë, të gjithë pjesëtarë të së njëjtës familje (mosha 38–72 vjeç; 2 meshkuj, 2 femra) nga fshati Cërunjë. . Masat e marra: marrja e mostrave të ujit, gjurmimi i kontakteve, forcimi i higjienës në familje, monitorim aktiv për raste të reja, njoftimi i institucioneve përkatëse dhe kontrolli i subjektit ushqimor të dyshuar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin prill 2026
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste prill 2026	Incidenca prill 2026 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	13	0.54
Shigelozë (Disenteri bacilare)	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	7	0.29
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6312	262.77
Sëmundje diarreike në total	6332	263.60

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit prill 2026 janë raportuar në total 196 raste të dyshuar me variçelë (incidenca 8.49/ 100.000 banorë). Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 84 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 97 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjate muajit prill jane raportuar 50 raste të dyshuar nga të cilët janë konfirmuar 40 raste nga ana laboratorike me metoden ELISA. Incidenca ne muajin prill eshtë 1.67 raste /100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas datës të fillimit të rashit



Sic shihet edhe nga kurba epidemike rastet janë në rritje gjatë muajit prill.

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruth sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Bulqize	2	7.5
Durrës	3	2.0
Kukës	2	5.5
Lezhë	1	1.9
Pogradec	1	2.2
Tiranë	30	5.0
Vlorë	1	1.2
Total	40	1.7

Rastet i përkasin kryesisht bashkisë Tiranë, por incidencën më të lartë e ka bashkia Kukës me 5.5 raste /100 000 banorë.

Tabela 3. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruth sipas grupmoshës

Grupmosha,vite	Raste	Incidençë
0-4 vjeç	27	24.1
5-14 vjeç	2	0.8
15-24 vjeç	5	1.7
25-44 vjeç	6	1.0
45-59 vjeç		
60 + vjeç		
Total	40	1.7

Shumica e rasteve janë të grupmoshës pediatrike 0-14 vjec, 32 raste (80%) janë të pavaksinuar dhe 4 (10%) raste jane me dy doze vaksinë FRP dhe 4 raste (10%) me një dozë. Të dhënat e vaksinimit janë verifikuar ne sistemin elektronik të informacionit mbi vaksinat (SIV).

Gjithashtu 29 (72.5%) raste janë të shtruar në spital ndersa 11 (27.5%) prej tyre u ndoqën në rrugë ambulatorë.

Hetimi epidemiologjik i rasteve është kryer nga shërbimi i epidemiologjisë në NJVKSH përkatëse ku janë identifikuar kontaktet dhe janë marrë masat e kontrollit të infeksionit.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin prill janë raportuar 33 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në këtë muaj është 1.37 raste/100 000 banorë në vend.

Prej tyre 11 raste janë të gjinisë mashkull (33.4%) dhe 22 femra (66.6%).

Tabela 4. Shpërndarje e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banore) me HBV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Bulqizë	1	3.73
Devoll	1	3.86
Dibër	4	7.88
Elbasan	3	2.61
Lezhë	1	1.95
Mallakaster	1	6.31

Tiranë	22	3.68
Total	33	1.37

Në muajin Prill rastet janë të shpërndara në disa bashki (tab 1) ku numrin më të lartë e ka Tirana me 22 raste, ndërkohë incidenca është më lartë në Dibër me 7.88 raste /100 000 banorë.

Tabela 5. Shpërndarje e rasteve dhe incidencë (raste/100 000 banorë) me HBV sipas grupmoshave (vite)

Grupmosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç	1	0.35
25-44 vjeç	13	2.21
45-59 vjeç	14	2.88
60 + vjeç	5	0.75
Total	33	1.37

Rastet në muajin prill i përkasin grupmoshës adulte dhe mungesë e tyre në grupmoshat pediatrike, kjo në sajë të vaksinimit ndaj HBV në këto grupmosha. Rasti në grupmoshës 15-24 vjeç është i moshës 19 vjeç.

Incidenca është me e lartë në grupmoshën 45-59 vjec dhe përkatesisht 2.88 raste per 100 000 banorë. Të gjithë rastet e konfirmuar te raportuar janë testuar për arësye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut B.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin prill janë raportuar 11 raste të konfirmuar me HCV. Incidenca e HCV per këtë muaj është 0.46 raste /100000 banorë.

Katër raste (36.3%) i përkasin gjinise mashkull dhe 7 raste (63.7%) asaj femër.

Tabela 6. Shpërndarje e rasteve dhe incidenca me HCV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Dibër	2	3.94
Durrës	2	1.30
Librazhd	1	4.29
Tiranë	6	1.00

Total	11	0.46
-------	----	------

Incidencën më të lartë e ka Librazhdi me 4.29 raste/100 000 banorë.

Tabela 7. Shpërndarje e rasteve dhe incidencë me HCV sipas grupmoshave (vite)

Grupmosha,vite	Raste	Incidence
0-4 vjec		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	3	0.51
45-59 vjeç	3	0.62
60 + vjeç	5	0.75
Total	11	0.46


Gjatë muajit prill, rastet janë të shpërndara ne grupmoshat adulte ku incidenca me e lartë i përket grupmoshës mbi 60 vjec me 0.75 raste /100 000 banorë.

Të gjithë rastet e konfirmuar të raportuar jane testuar për arësye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut C

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS


Gjatë muajit Prill 2026 janë kryer 39 ekzaminime për HIV (24 meshkuj dhe 15 femra) prej të cilëve 19 raste (15 meshkuj dhe 4 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv

Grafiku 3. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë në muajin Prill 2026.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitive është : 9 raste Tirane , 3 raste Durres, 1 rast Elbasan, 1 rast Fier, 1 rast Kurbin, 1 rast Korçë, 1 rast Vlorë dhe 2 raste me shtetesi të huaj (me vendbanim të përkohshëm në vendin tonë)

Grafiku 4. Shpërndarja gjeografike e rasteve të konfirmuara



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 0-15 vjeç, 5 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 5 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç, 3 raste i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç, 3 raste i përkasin grup-moshës 55-64 vjeç dhe 2 raste i përkasin grup-moshës mbi 65 vjeç.

Rastet e konfirmuara janë referuar si më poshtë:

8 raste vijnë nga laboratorë/spitale private (4 raste Genius, 1 rast CAMBRIDGE dhe 1 rast INTERMEDICA dhe 1 rast -PEGASUS),


4 raste vijnë nga Klinika Ambulatore Infektiv,

1 rast vjen nga pediatria,
1 rast vjen nga SUSM,
4 raste vijnë nga QKTGJ dhe pas njoftimit janë paraqitur në ISHP.
1 rast është referuar nga NJVKSH Korçë,
dhe 1 rast referuar nga NJVKSH Fier.

Sifiliz

Gjatë muajit prill 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 9 raste të konfirmuara me Sifiliz, incidence është 0.37 raste për 100000 banorë.

Grafiku 5. Shpërndarja e incidencës sipas grupmoshave



Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 5 meshkuj e 4 femra.

Gjatë këtij muaji kemi raportim të një rasti sifilizi kongenital, fëmijë i moshës 6 muajsh, nga bashkia Dibër. Shpërndarja sipas grupmoshave është nga 5 raste për grupmoshat 25-34 vjec, 2 raste në grupmoshën 35-44 vjec dhe në grupmoshën 25-34 vjec janë 4 raste.

Rastet vijnë nga bashkitë: Belsh, Tiranë, Elbasan, Dibër dhe Durrës.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit Prill 2026 janë raportuar gjithësej 19 raste me tuberkuloz (TB). 17 raste janë pulmonare dhe 2 raste janë ekstrapulmonarë, të konfirmuara me ekzaminime laboratorike. Rastet pulmonare janë të shpërndara përkatesisht: 6 në Tiranë, 2 në Shkodër, 1 në Bilisht, 2 raste në Durrës, 1 në Bulqizë, 3 në Dibër, 1 në Sarandë dhe 1 rast në Krujë.

Këtë muaj kemi 2 raste ekstrapulmonare në rrethin e Tiranës dhe 1 rast recidiv në rrethin e Durrësit.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria dhe NjVKSh-të e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB këtë muaj janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 8. Shpërndarja e zoonozave në muajin prill 2026, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciziozë)

	Prill (raste 2026)	Incidenca (raste/100,000) 2026
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	9	0.37
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin prill janë raportuar 9 raste Brucelozë përkatësisht : 2 nga Gjirokastra, 4 nga Cerriku , 2 Tepelene, 1 Kukes

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit prill 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 5 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin prill është 0.02 raste /100000 banorë.

Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas grupmoshave



Gjatë këtij muaji ka një rast të shtruar në spital.

Grafiku 7. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive



Në të 5 bashkitë janë raportuar nga një rast.

Gjatë muajit prill 2026 është raportuar zero raste vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 80% (4 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve dhe një rast është konfirmuar në laboratorin e ISHP.

7.2 Grip

Gjatë muajit prill janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 216 raste të dyshuara me Grip, nga të cilat asnjë rast nuk rezultuar pozitive për grip.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Meningit

Gjatë muajit prill 2026, nga Shërbimi i Pediatriisë në QSUT janë raportuar dy raste me meningit.

Rasti i parë, i gjinisë mashkullore, i përket grupmoshës 0–4 vjeç, me vendbanim në Konispol të Sarandës. Ai u diagnostikua me sëmundje meningokoksike të shkaktuar nga *Neisseria Meningitidis*.

Rasti i dytë, i gjinisë mashkullore, i përket grupmoshës 5–9 vjeç, me vendbanim në Shkodër. Ai u diagnostikua me meningit tuberkular.

Për të dy rastet janë kryer hetimet përkatëse dhe janë marrë masat e nevojshme për kontrollin dhe parandalimin e përhapjes së infeksionit.

8.2 *Leishmania visceralis*

Gjatë muajit prill është raportuar një rast i konfirmuar me *L. visceralis* nga bashkia Peshkopi, grupmosha 0-4 vjeç.